

Formular për SYLLABUS të Lëndës

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti Juridik
Titulli i lëndës:	Ndihma juridike dhe ekstradimi
Niveli:	Master
Statusi lëndës:	Zgjedhore
Viti i studimeve:	2020/21
Numri i orëve në javë:	2 + 1
Vlera në kredi – ECTS:	3
Koha / lokacioni:	E enjte 13.00 – 14.30
Mësimdhënësi i lëndës:	Dr.Azem Hajdari
Detajet kontaktuese:	Viti I
Përshkrimi i lëndës	<p>Ndihma juridike dhe ekstradimi është pjesë e shkencës juridike penale e cila i kontribuon luftës së suksesshme kundër kriminalitetit. Në bazë të plan-programit mësimor të Fakultetit Juridik të Universitetit të Prishtinës në Prishtinë, lënda-Ndihma juridike dhe ekstradimi, si lëndë fakultative në vitin shkollor 2019/2020, e cila ligjërohet në semestrin e dytë, përfshinë njësitë e zgjedhura mësimore në vitin e parë, semestrin e dytë të studimeve Master, përfshinë njësitë e zgjedhura mësimore që lehtësojnë arritjen e njohurive mbi çështjet që i referohen, të thuash, të gjitha aspekteve të veprimeve procedurale që ndërmerren në lëmin e ndihmës juridike penale ndërkombëtare, të cilat në një mënyrë apo tjetër janë objekt i studimit të shkencave juridike penale.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Ky program mësimor mundëson përvetësimin dhe thellimin e njohurive nga Ndihma juridike dhe ekstradimi, e cila si pjesë e shkencës juridiko-penale, në kuptimin e gjerë të fjalës i kontribuon luftës kundër kriminalitetit, sidomos atij ndërkombëtar. Programi mësimor nga lënda Ndihma juridike dhe ekstradimi, do të shtjellohet në aspektin teorik dhe atë praktik (nëpërmjet ligjëratave, përpilimin e shkresave proceduralo-penale që ndërlidhen me ekstradimin dhe ndihmën juridike), seminareve, debateve dhe diskutimeve me studentë). Qëllimi i këtij programi është përgatitja dhe aftësimi i studentëve, që si jurist të ardhshëm me lehtësi të përballen me sfidat e zgjidhjes së çështjeve të ndryshme me natyrë proceduralo-penale, veçanërisht të atyre që ndërlidhen me</p>

	<p>ekstradimin dhe ndihmën juridike, të adresojnë çështjet themelore që kanë të bëjnë me modalitetet e bashkëpunimit juridik ndërkombëtar në çështjet penale, kërkesa dhe përgjigje në kërkesat që vijnë nga shtetet e ndryshme përmes të cilave kërkohet ndihmë juridike penale, të adresojnë drejtë çështjet që lidhen me kompetencat e autoriteteve që vendosin për ekstradimin dhe ndihmën juridike penale ndërkombëtare etj.</p>
<p>Rezultatet e pritura të nxënies:</p>	<p>Ky program mësimor përfshinë njësitë e zgjedhura mësimore që lehtësojnë arritjen e njohurive mbi çështjet që i referohen, të thuash, të gjitha aspekteve të veprimeve procedurale që ndërmerren në lëmin e ndihmës juridike penale ndërkombëtare, të cilat në një mënyrë apo tjetër janë objekt i studimit të shkencave juridike penale. Me trajtimin e njësisë të caktuar të lëndës së Ndihma juridike dhe ekstradimi, studentëve u ofrohet njohuri se çfarë duhet bërë ata si gjyqtarë të ardhshëm që t'i zgjidhin drejtë dhe brenda afateve procedurale problemet që ndërlidhen me ndihmën juridike penale ndërkombëtare të çështjeve penale konkrete. Në sistemin e mësimin zbatohen metodat përkatëse të shtjellimit të lëndës, ashtu që organizohen debate, teste, seminare e kollokviume me qëllim të nxitjes së punës aktive në zhvillimin e procesit mësimor. Me këto metoda mësimore, studenti që kryen fakultetin juridik aftësohet me njohuri themelore rreth mënyrës së veprimit të gjykatave dhe autoriteteve tjera kompetente (Ministrisë së Drejtësisë) në zgjidhjen efikase, të ligjshme dhe të drejtë të çështjeve penale me elemente ndërkombëtare. Vlerësimi i studentit gjatë kohës së ligjëratave bëhet edhe me testim. Kështu, çdo muaj organizohen testet e vlerësimit.</p> <p>Pas përfundimit të këtij kursi studenti do të jetë në gjendje që:</p> <ol style="list-style-type: none"> 1. Të kuptojë çështjet fundamentale që ndërlidhen me ndihmën juridike penale ndërkombëtare, 2. Të adresojë e vendosë lidhur me kërkesat për ndihmë juridike penale ndërkombëtare, 3. Të hartojë shkresa të ndryshme me natyrë proceduralo- penale nga lëmi i bashkëpunimit juridik penal ndërkombëtar.

Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	2	15	30
Ushtrime teorike/laboratorike	1	13	13
Punë praktike	1	5	05
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	5	05
Ushtrime në teren	-	-	-
Kollokfiume,seminare	5	5	25
Detyra të shtëpisë	5	5	25
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë ose në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	2	15	30
Koha e kaluar në vlerësim (teste,kuiz,provim final)	1	10	10
Projektet,prezentimet ,etj	1	10	10
Totali	22	98	183
Metodologjia e mësimdhënies:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Në pjesën më të madhe të kohës do të mbahen ligjërata interaktive, që do me thënë, që përveç ligjërimit të mësimdhënësit, kyçen edhe studentët duke u pyetur, diskutuar, këmbyer mendimet mbi çështjet tematike që janë objekt i ligjëratisë. 2. Punimet seminarike përcaktohen sipas zgjedhjes së studentit. Atyre u ofrohen udhëzime se si duhet përgatitur seminarët. Pastaj bëhet dorëzimi i punimit seminarik, mësimdhënësi e kontrollon atë, pastaj në orët e caktuara mësimore, lexohet nga studenti dhe hapet diskutimi lidhur me to. 3. Ushtrime në përpilimin e akteve të ndryshme përmes të cilave adresohen çështjet e ndihmës juridike penale ndërkombëtare. Simulohet rasti i caktuar, studentëve u shtrohet detyra që të përgatisin psh., një kërkesë për ndihmë juridike, e pastaj hapet diskutimi dhe komentohet 		

	çështja.
Metodat e vlerësimit:	Vlerësimi i studentëve do të bëhet përmes zbatimit të këtyre metodave: 1.Provimeve, 2. Kolokvimeve, 3.Prezantimeve, 4.Punimeve seminarike, 5.Pjesëmarrjes në debate etj.
Literatura	
Literatura bazë:	Hajdari A., Ndhimja juridike dhe ekstradimi, Prishtinë, 2014, Pradel J. etj. E drejta penale evropiane, Tiranë, 2010.
Literatura shtesë:	Fausto I. E drejta procedurale penale, Përkthim, Tiranë, 2002. Samaha J., Criminal procedure, Boston, 2014, Rolando V. Criminal Procedure: Law and Practice, New York, 2016, Swanson Ch. Criminal Investigation, London, 2014 Grigor Gj. Procedura penale e RPSH, Pjesa e posaçme, Tiranë, 1970, Grubač M. Krivično procesno pravo, Posebni deo, Beograd, 2004, Hajdari A. E drejta e procedurës penale. Pjesa e përgjithshme, Prishtinë, 2014, Islami H. etj. Procedura penale, Tiranë,2003, Konventat evropiane (ekstradimin, ndihmën juridike në fushën penale, transferimin e procedimeve në çështjet penale, transferimin e personave të dënuar, mbikëqyrjen e personave të dënuar, vlefshmërinë ndërkombëtare të gjykimeve penale, mbikëqyrjen e personave të dënuar ose liruar me kusht). Matovski N. Kazнено procesno pravo, Skopje, 2004, Nova K.Proçedura penale, Pjesa e përgjithshme, Tiranë, 1966, Panta M. Komentaret na zakonot za krivičnata postopka, Skopje, 1979, Pavišić B. etj.Zakon o kaznenom postupku, Zagreb, 1998, Sierčić Č. Krivično procesno pravo, Sarajevo, 2005 Stevanović Č i dru. Krivično posebno pravo,

	Beograd, 1997,
Plani i dizajnuar i mësimit:	
Java	Ligjerata që do të zhvillohet
Java e parë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Nocioni dhe objekti i studimit të lëndës së ndihmës juridike dhe ekstradimi 2. Funkzioni mbrojtës i ndihmës juridike dhe ekstradimit 3. Sistemimi i lëndës së ndihmës juridike dhe ekstradimit 4. Instrumentet e bashkëpunimit midis shteteve në çështjet penale 5. Kushtet e bashkëpunimit midis shteteve
Java e dytë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Nocioni i ekstradimit 2. Qëllimi i ekstradimit 3. Obligimi i ekstradimit 4. Një historik i shkurtër i ekstradimit në Evropë
Java e tretë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Parimet themelore të ekstradimit 2. Pengesat për ekstradim
Java e katërt:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Procedura e ekstradimit 2. Detyrimet e shtetit të kërkuar lidhur me ekstradimin 3. Detyrimet e shtetit kërkues 4. Transiti 5. Shpenzimet e ekstradimit
Java e pestë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kuptimi dhe arsyeshmëria e transferimit të procedurës penale shtetit të huaj 2. Mënyrat e transferimit të procedurës 3. Efektet e procedimit të kërkesës së transferimit të procedurës
Java e gjashtë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Procedurat e filluara në dy ose më shumë shtete 2. Pengesat e transferimit të procedurës-parimi Ne Bis in Idem 3. Disa çështje specifike të transferimit të procedurës sipas legjislacionit penal të
Java e shtatë:	<ol style="list-style-type: none"> 1. Kuptimi i transferimit të personave të dënuar 2. Disa çështje parimore të mbikëqyrjes së personave të dënuar apo të liruar me kusht 3. Kushtet e bashkëpunimit në çështjen e transferimit dhe

	mbikëqyrjes së personave të dënuar apo liruar me kusht 4. Modalitetet e bashkëpunimit midis shteteve në çështjen e mbikëqyrjes së personave të dënuar apo liruar me kusht
Java e tetë:	1.Transferimi i personave të dënuar me burgim 2. Pagesa e gjobave 3.Procedura për transferimin e të dënuarve sipas legjislacionit penal të Kosovës 3. Ekzekutimi i vendimeve të huaja në Kosovë
Java e nëntë:	1. Nocioni dhe qëllimet e ndihmës së “vogël” juridike penale ndërkombëtare 2. Një historik i shkurtër i zhvillimit të ndihmës së “vogël” juridike penale ndërkombëtare 3. Rregullativa juridike ndërkombëtare për ndihmën e “vogël” juridike penale ndërkombëtare 4. Parimet e ndihmës së “vogël” juridike penale ndërkombëtare 5. Pengesat për dhënien e ndihmës së “vogël” juridike penale ndërkombëtare
Java e dhjetë:	1.Veprimet e veçanta të ndihmës së “vogël” juridike penale ndërkombëtare 2. Ndihma juridike me anë të konsullit 3. Procedura për dhënien e ndihmës së “vogël” në fushën penale 4. Ndihma e “vogël” juridike penale ndërkombëtare direkte 5. Mbledhja dhe veçimi i të dhënave për vepra penale të rënda
Java e njëmbëdhjetë:	1.Këndvështrim i disa konventave që u referohen disa llojeve të veprave penale 2. Konventat Evropiane Kundër Shkeljeve Rrugore
Java e dymbëdhjetë:	1.Parimet dhe teknikat e funksionimit të ndihmës juridike ndërkombëtare në lëmin e komunikacionit rrugor 2.Konventa për Mos-parashkrimin e Krimeve të Luftës dhe Krimeve Kundër Njerëzimit
Java e trembëdhjetë:	1.Konventa Kundër Torturës dhe Dënimeve apo Trajtimeve tjera Mizore, Çnjerëzore dhe Degraduese

	<p>1.4. Konventa Europiane Kundër Trafikimit të Qenieve Njerëzore</p> <p>2.Konventa mbi Pastrimin, Zbulimin dhe Konfiskimin e Produkteve të Krimin</p> <p>3.Konventa Evropiane Kundër Korrupsionit dhe Protokolli i saj Shtesë</p>
Java e katërbëdhjetë:	<p>1.Konventat në lidhje me persona të caktuar</p> <p>2.Konventa për Dëmshpërblimin e Viktimave të Veprave Penale</p>
Java e pesëmbëdhjetë:	<p>1. Konventa për Riatdhesimin e të Miturve</p> <p>2. Konventa për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Shfrytëzimi dhe Abuzimet Seksuale</p>

Politikat akademike dhe rregullat e mirësjelljes:

Përmes punës me student do të arrihet në:

1. Avancimin e dijes, ideve kreative dhe shkencës,
2. Avancojë zhvillimin e arsimit, shkencës, kulturës, shoqërisë dhe ekonomisë së Kosovës;
- 3.Ndihmohet në procesin e promovimit të demokracisë qytetare;
- 4.Krijimin dhe mbështetjen e standardeve më të larta në fushën e mësimdhënies dhe mësim nxënies si dhe kërkimeve shkencore;
- 5.Zhvillimin e personalitetit të shëndoshë dhe kreativ etj.